

KONTRATË

E lidhur në Gjakovë, me dt.20.11.2018, në mes të :

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoritetit Kontraktues)
dhe

“ EUROCOM” shpk & NTSH “Marash-Shped”shpk - Prishtinë, me nr.biznesit 70481414
& 70232350 (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi)

të cilët janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS –“ Punët e kulmit në Shtëpinë Muze të familjes Qerkezi”

Numri i identifikimit – 632-18-096-536

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Punët e kulmit në Shtëpinë Muze të familjes Qerkezi**, për Autoritetin kontraktues, sipas specifikave të dhëna nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si vijon:
- 1.2 Kontraktuesi duhet të kryej punët në pajtushmëri të plotë me Kushtet e kontratës , specifikimet e detyrueshme teknike dhe paramasën me paralogari.
- 1.3 Kontrata do të nënshkruhet me dt.20.11.2017.
- 1.4 Kryerja e punëve do të filloj pas urdhëresës me shkrim të Menaxherit të projektit dhe do të përfundoj brenda **21 ditë** .
- 1.5 Vendi i ekzekutimit të punëve është në **Shtëpinë Muze të familjes Qerkezi në Gjakovë**.
- 1.6 Mbikëqyerja dhe pranimi i punimeve do të bëhet nga firma “AL-Engineering” & “Project Plus” , mob.044/200-285.

1.7 Menaxher i projektit është Rexhë Rexha, mob.044/188-433. Menaxheri i Projektit është personi përgjegjës që do të përcjellë implementimin e kontratës, kualitetin e punëve dhe njëherit do të bëjë vlerësimin e punëve të realizuara.

Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës bashkë me Tvsh është **4.795,00€(katërmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë euro)**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat do të kryhen pas dorëzimit të **procesit të pranimit të punimeve dhe faturës**.

4.3 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të punëve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *te kryej ndonjë ose te gjitha punët* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *punëve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e

res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Rita Bala	Emri:	Komuna e Gjakovës - Albana Bakalli
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxherë e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.11.2018	Data:	20.11.2018
Vula:		Vula:	



PARAMASA PËR KRYERJEN E PUNËVE

PUNET E KULMIT NE SHTEPINE MUZE TE FAMILJES QERKEZI NE GJAKOVË

Vërejtje: Të gjitha materialet e përdorura duhet të jenë të kiasit të parë, mostrat paraprakisht duhet të aprovohen nga organi mbikqyres. Në të gjitha pozicionet përfshihet furnizimi me material si dhe montimi i tij. Në rastet e demolimit, të gjitha mbeturinat të dërgohen në deponi. Përndonjë ndryshim eventual, paraprakisht të konsultohet Projektanti.

1. PUNËT NDËRTIMORE

Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH - €	Çmimi total me TVSH - €
1 PUNËT PREGATITORE					
1.1	Përgaditja e kompanise për fillimin e punimeve, bartja e mjeteve të punës, makinerive dhe paisjeve tjera të nevojshme për punë.	copë	1	100.00	100.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT PREGATITORE					100.00

2. PUNËT DEMONTUESE-DEMOLUESE

Demolimet në kulëm të objektit					
2.1	Demolimi i tjegullave në tërësi sipërfaqen e kulmit të objektit, bartja e materialit deri në deponi (e cakton investitori)	m ²	130.00	1.00	130.00
2.2	Demolimi i konstruksionit të kulmit përfshirë mahite 10/12 cm, trajet, dyreker, dërrasat e strehes etj., bartja e materialit deri në deponi (e cakton investitori).	m ²	130.00	1.00	130.00



2.3	Demolimi i listelave nga kulmet e pjerrëta,,bartja e materialit deri ne deponi (e cakton investitori).	m ²	130.00	0.80	104.00
2.4	Demolimi ulluqeve horizontale, bashk me llamarinen (bartja e materialit deri ne deponi(e cakton investitori).	m'	20.00	1.00	20.00
	Demontimi ose demolimi ulluqeve vertikale nga kulmi				
2.5	.Deponimi i ulluqeve qe munde te perdoren perseri (duke i sanuar dhe adoptuar), ndersa ulluqet qe s'mund te perdoren duhet te largohen nga objekti-barten deri ne deponi (e cakton investitori). Verejtje: Ne rast se olluqen nuk eshte e nevojshme te demontohen(nese s'pengojne) te mos demontohen.	m'	20.00	1.00	20.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT DEMONTUESE-DEMOLUESE					404.00
3. PUNËT E KULMIT-MBULESES DHE LLAMARINËS					
3.1	Furnizimi me lëndë druri (halor kateg.II) me dimensione 10/12 cm dhe punimi i konstruksionit të kulmit duke përfshirë trarët e kurorave, nëntrarët dhe brinjët në çdo 70 cm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse të nevojshme si gozhda, vida si dhe ankerë bulonat së paku në çdo metër për ankerimin në trarët horizontal dhe të pjerrët nga betonarmeja. Verejtje: Konstruksioni i kulmit punohet sipas projektit.	m ³	4.00	160.00	640.00
3.2	Furnizimi me material si dhe punimi i dyshemesë nga OSB panelet t=14mm mbi konstruksionin mbajtës - respektivisht mbi brinjët/mahitë e kulmit sipas projektit. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si gozhda ose vida. Verejtje: DysHEMEJA nga OSB panelet punohet mbi të gjitha kulmet e pjerrëta.	m ²	120.00	5.00	600.00



	<p>Furnizimi me material dhe shtrirja e membranës hidroizoluese difuzive si membrana kompozite me shirit vetngjitës dhe e përbërë nga filmi/shtresa termoplastike e bashkëdyzuar në shtresën e poliesterit të përforcuar si Rothoblass Transpir Zenit Evo 180 ose membrana të ngjashme për kulme të ventiluara.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trashësia 0.8 mm 				
3.3	<p>• Peshë: 180 gr/m²</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rezistenca ndaj temperaturave: -40°C deri +100°C <p>Vërejtje: Membrana hidroizoluese difuzive duhet të vendoset në të gjitha kulmet e pjerrëta duke respektuar udhëzimet e prodhuesit për ngjitje në dyshtemenë nga panelet si dhe mënyrën e mbylljes së vazhdimt të membranave duke përfshirë edhe masat ngjitëse dhe shiritat izolues.</p>	m ²	120.00	1.60	192.00
3.4	<p>Furnizimi me material si dhe vendosja e kontralistelave 2x4 cm nga druri në aksin e brinjëve mbi membranën hidroizoluese difuzive. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si gozhda ose vida.</p> <p>Vërejtje: Kontralistellat duhet të vendosen në të gjitha kulmet e pjerrëta për të mundësuar qarkullimin e ajrit.</p>	m ²	180.00	1.00	180.00
3.5	<p>Furnizimi me material si dhe vendosja e listelave 3x5 cm nga druri. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse si gozhda ose vida.</p> <p>Vërejtje: Listellat duhet të vendosen në të gjitha kulmet e pjerrëta maksimum në çdo 30 cm.</p>	m'	180.00	1.00	180.00




3.6	Furnizimi dhe montimi i tjegullave te argjilles me nuance te kuqerremet te tipit Mediteran. Perzgjedhjen e mostres se tjegulles e ben Investitori Verejtje: Gjat demolimit te kulmareve dhe lugjeve ka mundesi te demtohen nje pjese e tjegullave prandaj duhet te plotesohen.	cope	1,200.00	1.20	1,440.00
3.6.1	Furnizimi dhe montimi i kulmareve nga argjila. Fiksimi i tyre te behet me llag cimente.	m'	10.00	5.00	50.00
3.7	Furnizimi me material dhe montimi i ulluqeve horizontale nga llamarina e plastifikuar me trashësi 0.55 mm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse dhe mbajtësit e nevojshëm për ruajtjen e formës dhe pozitës. Vërejtje: Olluqet të montohen tek kulmet me pjerrtësi 30°	m'	16.00	8.00	128.00
3.80	Furnizimi me material dhe montimi i ulluqeve vertikale nga llamarina e plastifikuar Ø120mm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse dhe mbajtësit e nevojshëm. Vërejtje: Olluqet të montohen tek kulmet me pjerrtësi 30°	m'	18.00	8.00	144.00
3.81	Furnizimi dhe montimi i strehes me derrasa t=14mm	m ²	16.00	5.00	80.00
3.9	Punë e kulmit mbi deponë prapa shtëpisë. Të bëhet furnizimi me material dhe montimi me llamarinë të valëzuar e të plastifikuar t=0.6mm. Vërejtje: Në çmim të përfshihet edhe demolimi i salonitkave të vjetra (pasi janë të dëmtuara dhe pikon uji)	m ²	40.00	8.00	320.00



3.9.1	Furnizimi me material dhe montimi i ulluqeve horizontale nga llamarina e plastifikuar me trashësi 0.55 mm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse dhe mbajtësit e nevojshëm për ruajtjen e formës dhe pozitës. Vërejtje: Olluqet e vjetra të demoloohen dhe të montohen të rinj në kulmin e objektit të dposë prapa shtëpisë.	m'	8.00	7.00	56.00
3.9.2	Furnizimi me material dhe montimi i ulluqeve vertikale nga llamarina e plastifikuar Ø120mm. Në çmim të përfshihen të gjitha mjetet lidhëse dhe mbajtësit e nevojshëm. Vërejtje: Olluqet të montohen tek kulmet me pjerrtësi 30°	m'	3.00	7.00	21.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E KULMIT-MBULESES DHE LLAMARINËS					4,031.00
4 PUNËT E ENTERIERIT-INVENTARIT					
Dollapët hermetik nga mediapani dhe qelqi					
4.1	Të bëhet furnizimi me material dhe montimi i dollapëve me dimensione 210x180x40cm. Dollapet do të jenë hermetik sipas skemave të projektit. Do të punohe nga kornizat e Mediapani 18mm dhe pjesët e ekspozimit nga Qelqi 6mm.	copë	1.00	100.00	100.00
4.2	Të bëhet furnizimi me material dhe montimi i dollapëve me dimensione 105x180x40cm. Dollapet do të jenë hermetik sipas skemave të projektit. Do të punohe nga kornizat e Mediapanit 18mm dhe pjesët e ekspozimit nga Qelqi 6mm.	copë	2.00	80.00	160.00
Gjithsej totali me TVSH - PUNËT E ENTERIERIT-INVENTARIT					260.00

REKAPITULLIMI - PUNËT E KULMIT NE SHTEPINE MUZE TE FAMILJES QERKEZI NE GJAKOVË



1	PUNËT PREGATITORE	100.00
2	PUNËT DEMONTUESE-DEMOLUESE	404.00
3	PUNËT E KULMIT-MBULESES DHE LLAMARINËS	4,031.00
4	PUNËT E ENTERIERIT-INVENTARIT	260.00
Gjithsej totali me TVSH		4,795.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	Marash Shped shpk
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Albert Bala
NËNSHKRIMI:	
DATA:	05.11.2018
VULA:	




PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	Eurocom'' Sh.P.K
Adresa	Qamil Hoxha''''
Qyteti	Prishtinë
Kodi Postar	10000
Kontakti	Rita Bala
Telefoni	044/701-702
Fax	
E-mail	eurocomshpk@gmail.com
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	NLB Prishtinë
Adresa	''N.Terezë
Qyteti	Gjakovë
Kodi Postar	50000
Shteti	Republika e Kosovës
Llogaria Bankare	1704001011315080
IBAN (opionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)

 **NLB Banka**
Ekspozitura Gjakovë - Shifra 273

[Signature]

DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)

[Signature]

 SH.P.K.
Eurocom
0481434